

# Leje e paguar për arsye sigurie dhe shëndetësore: Çfarë duhet të dinë punëmarrësit

Ndryshimet e reja në ligjin e qytetit të Nju-Jorkut “Për kohën e paguar për arsye sigurie dhe shëndetësore” (ligji “Për lejen e paguar për arsye sigurie dhe shëndetësore”) hyjnë në fuqi më datë 30 shtator 2020 dhe 1 janar 2021. Nëse punoni me kohë të pjesshme apo të plotë në ndonjë biznes të çfarëdolloj madhësie ose jofitimprurës në qytetin e Nju-Jorkut apo nëse punoni në një familje njujorkeze si punëtor/e shtëpiak/e, lexoni këtë fletë informative<sup>1</sup> për të kuptuar të drejtat e punëmarrësit. Sipas kuptimit të ligjit, punëmarrësit e mbuluar kanë të drejtën ta përdorin këtë leje:

- për arsye shëndetësore, ku përfshihet kujdesi dhe trajtimi për veten ose për një anëtar të familjes; dhe
- për arsye sigurie, ku përfshihet kërkimi i ndihmës ose marrja e masave të tjera të sigurisë nëse punëmarrësi ose një anëtar i familjes mund të jetë viktimë e një akti apo kërcënimi të dhunës në familje, kontakti seksual kundër dëshirës, përndjekjes apo trafikimit të qenieve njerëzore.

## Punëmarrësit që mbulohen/nuk mbulohen nga ligji

Mbulohen	Nuk mbulohen
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Punëmarrësit me kohë të plotë</li> <li>• Punëmarrësit me kohë të pjesshme</li> <li>• Punëtorë/e shtëpiakë/e</li> <li>• Punëmarrësit në programin e kalimit në tregun e punës</li> <li>• Punëmarrësit që janë anëtarë të familjes, por jo pronarë</li> <li>• Punëmarrësit që banojnë jashtë qytetit të Nju-Jorkut</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Studentët në programet federale të punës dhe studimit</li> <li>• Punëmarrësit puna e të cilëve kompensohet nga programe të kualifikuara për bursa studimi</li> <li>• Punëmarrësit në agjenci qeveritare</li> <li>• Fizioterapistët, ergoterapistët, ortofonistët, audiologët të cilët janë të licencuar nga Departamenti i Arsimit i shtetit të Nju-Jorkut (New York State Department of Education) (nëse marrin përsipër detyra me vullnetin e tyre, përcaktojnë vetë orarin e tyre të punës, kanë mundësi të refuzojnë ose pranojnë çdo detyrë që iu është referuar dhe paguhen me një pagë mesatare për orë pune që është të paktën sa katërfishi i pagës federale minimale)</li> <li>• Kontraktorët e pavarur që nuk janë në pajtueshmëri me përkufizimin e një punëmarrësi sipas ligjit “Për punën” të shtetit të Nju-Jorkut</li> <li>• Pjesëmarrësit në programet e përvojës së punës (Work Experience Programs, WEP)</li> <li>• Disa punëmarrës të caktuar që janë objekt i një kontrate kolektive</li> </ul>

**Shënim:** Nëse punëdhënësi juaj ka një politikë ekzistuese sipas së cilës punëmarrësve iu lejohet përdorimi i lejes për arsye sigurie dhe shëndetësore, politika në fjalë duhet të përmbushë ose të tejkalojë kërkesat e ligjit.

## Njoftim për të drejtat e punëmarrësit

Nëse jeni një punëmarrës i mbuluar, punëdhënësi juaj duhet t’ju lëshojë një njoftim me shkrim për të drejtën tuaj të lejes për arsye sigurie dhe shëndetësore. Ju gëzoni të drejtën për ta marrë këtë njoftim në gjuhën angleze dhe në gjuhën tuaj të parë, nëse disponohet një version i përkthyer në faqen e internetit të DCWP-së [nyc.gov/workers](http://nyc.gov/workers). **Mbani një kopje të njoftimit të lëshuar.** Punëdhënësi juaj duhet gjithashtu ta afishojë njoftimin në vendin e punës, në një ambient të dukshëm dhe të aksesueshëm nga të gjithë punonjësit.

## Totali i orëve të lejes për arsye sigurie dhe shëndetësore

Numri i punëmarrësve të punësuar nga punëdhënësi	Të ardhurat vjetore të punëdhënësit	Totali i orëve të lejes për çdo vit kalendarik*	Leje e paguar ose e papaguar
1 - 4	Më pak se 1 milion \$	Deri në 40 orë	E papaguar
	<b>hyn në fuqi më datë 1.1.2021:</b> 1 milion dollarë ose më shumë	Deri në 40 orë	E paguar
5 apo më shumë të punësuar nga punëdhënësi në sektorin privat ose jofitimprurës OSE <b>hyn në fuqi më datë 30.9.2020:</b> 1 apo më shumë punëtor/e shtëpiak/e të punësuar nga punëdhënësi familjarë	N/A	Deri në 40 orë	E paguar
<b>hyn në fuqi më datë 1.1.2021:</b> 100 apo më shumë të punësuar nga punëdhënësi në sektorin privat ose jofitimprurës ose nga punëdhënësi të punëtorit/es shtëpiak/e	N/A	Deri në 56 orë	E paguar

\*Shënim: “Viti kalendarik” është çdo periudhë kohore 12-mujore e rregullt dhe e vazhdueshme e përcaktuar nga punëdhënësi. Në njoftimin për të drejtat e punëmarrësit duhet të deklarohet viti kalendarik i punëdhënësit.

Nëse punëdhënësi i kërkohet të japë leje të paguar për arsye sigurie dhe shëndetësore, juve duhet t’ju paguhet tarifa e zakonshme për orë dhe jo më pak se paga minimale aktuale.

## Akumulimi dhe përdorimi i lejes për arsye sigurie dhe shëndetësore

Ju:

- Nisni akumulimin e lejes për arsye sigurie dhe shëndetësore që në momentin e fillimit të marrëdhënies suaj të punës. Norma minimale e akumulimit është 1 orë për çdo 30 orë të kryera pune.
- Mund ta përdorni lejen për arsye sigurie dhe shëndetësore menjëherë teksa akumulohet.
- Duhet të pajiseni nga punëdhënësi juaj, në çdo periudhë pagese, me një dokument me shkrim ku të pasqyrohen orët e përdorura, të akumuluar dhe të mbetura të lejes për arsye sigurie dhe shëndetësore.

<sup>1</sup> Vini re datën në pjesën e pasme. Mbrojtësi i Konsumatorit dhe Punonjësve i qytetit të Nju-Jorkut (Department of Consumer and Worker Protection, DCWP) do të përditësojë këtë fletë sipas rastit. Monitoroni faqen e internetit [nyc.gov/workers](http://nyc.gov/workers) për përditësime.

**Përfashtim:** Nëse mbuloheni nga një kontratë kolektive e hyrë në fuqi më datë 1 prill 2014, akumulimi i lejes për arsye sigurie dhe shëndetësore sipas ligjit fillon në datën e skadimit të kontratës.

## Arsyet e pranueshme për të përdorur lejen për arsye sigurie dhe shëndetësore

Ju mund ta përdorni lejen për arsye sigurie dhe shëndetësore për të marrë pushim nga puna kur:

- Keni një sëmundje mendore ose fizike, lëndim ose gjendje shëndetësore; ju nevojitet të kryeni një diagnostikim, kujdes apo trajtim mjekësor për sëmundjen tuaj mendore ose fizike, lëndimin apo gjendjen shëndetësore; ju nevojitet të merrni kujdes mjekësor parandalues.
- Ju duhet të kujdeseni për një anëtar të familjes që ka nevojë për diagnostikim, kujdes apo trajtim mjekësor për një sëmundje mendore ose fizike, lëndim apo gjendje shëndetësore, ose që ka nevojë për kujdes mjekësor parandalues.
- Biznesi i punëdhënësit tuaj mbyllet për shkak të një emergjence të shëndetit publik ose kur ju duhet të kujdeseni për një fëmijë, shkolla ose ofruesi i kujdesit të të cilit është i mbyllur për shkak të një emergjence të shëndetit publik.
- Ju ose një anëtar i familjes mund të jeni viktimë e një akti apo kërcënimi të dhunës në familje, kontakti seksual kundër dëshirës, përndjekjes apo trafikimit të qenieve njerëzore dhe ju duhet të merrni masat e nevojshme për të rikthyer shëndetin ose sigurinë fizike, psikologjike ose ekonomike tuajën apo të anëtarëve të familjes suaj ose ju duhet të mbron personat që shoqërohen ose punojnë me ju, si edhe:
  - Për të marrë shërbime nga një strehë mbrojtëse ndaj dhunës në familje, nga një qendër për trajtimin e krizave për shkak të përdhunimit ose nga program tjetër shërbimesh.
  - Për të marrë pjesë në planifikimin e sigurisë, zhvendosjen ose marrjen e masave të tjera për të mbrojtur sigurinë tuaj ose të anëtarëve të familjes suaj, duke përfshirë edhe regjistrimin e fëmijëve në një shkollë të re.
  - Për të takuar një avokat ose një ofrues të shërbimeve sociale me qëllim marrjen e informacioneve dhe këshillave lidhur me kujdestarinë, vizitat, çështjet martesore, urdhrat e mbrojtjes, emigrimin, strehimin, diskriminimin në punësim, kreditë për strehim apo ato konsumatore.
  - Për të depozituar pranë agjencive ligjzbatuese një raport incidenti në familje ose për një takim në zyrën e prokurorit të distriktit.

Ligji njeh si “anëtarë të familjes” individët e mëposhtëm:

- Çdo individ marrëdhënie e ngushtë e të cilit me punëmarrësin është e barasvlershme me një marrëdhënie familjare
- Fëmijën (fëmija biologjik, i birësuar ose i marrë nën kujdestari; nga kujdestaria ligjore; fëmija i një punëmarrësi me statusin *in loco parentis*)
- Nipin/mbesën
- Bashkëshortin/en
- Partnerin/en bashkëjetues/e
- Prindin
- Gjyshin/en
- Fëmijën ose prindin e bashkëshortit/es ose partnerit/es bashkëjetues/e të një punëmarrësi
- Vëllain/motrën (duke përfshirë vëllanë/motrën nga njëri prind, të birësuar ose nga njerku/njerka)
- Çdo individ tjetër me lidhje gjaku me punëmarrësin

## Njoftimi paraprak

Nëse nevoja për leje është e parashikueshme, punëdhënësi mund të kërkojë një njoftim paraprak deri në shtatë ditë përpara për qëllimin tuaj për të përdorur lejen për arsye sigurie ose shëndetësore. Nëse nevoja për leje nuk është e parashikueshme, punëdhënësi mund të kërkojë që ta njoftoni sa më shpejt që të jetë e mundur (e arsyeshme). Punëdhënësi mund t’ju kërkojë që të siguroni një verifikim me shkrim që leja për arsye sigurie ose shëndetësore është përdorur realisht për këto arsye.

## Dokumentacioni

Punëdhënësi mund t’ju kërkojë dokumentacion përkatës nëse përdorni më shumë se tri ditë pune rresht si leje për arsye sigurie ose shëndetësore. Punëdhënësi mund t’ju kërkojë:

- një raport mjekësor të nënshkruar nga një ofrues i licencuar i kujdesit shëndetësor; ose
- dokumentacion nga një ofrues i shërbimeve sociale, ofrues i shërbimeve ligjore, anëtar i klerit ose një letër të noterizuar të shkruar nga ju, ku cilësoni nevojën e lejes për arsye sigurie.

*Punëdhënësi nuk mund t’ju kërkojë që të specifikoni në dokumentacion motivin e lejes për arsye sigurie ose shëndetësore. Zbulimi i këtyre motiveve mund të kërkojë në bazë të ligjeve të tjera.*

Punëdhënësi duhet t’ju kompensojë për:

- çdo tarifë që ju është vendosur nga ofruesit e kujdesit shëndetësor për të siguruar dokumentacionin e lejes për arsye shëndetësore; dhe
- të gjitha kostot ose shpenzimet e arsyeshme për të siguruar dokumentacionin e lejes për arsye sigurie.

## Leja e papërdorur për arsye sigurie dhe shëndetësore

Ju mund të mbartni në vitin pasues kalendarik deri në 40 orë (ose 56 orë, sipas rastit, nga 1 janari 2021) leje të papërdorur për arsye sigurie dhe shëndetësore. Megjithatë, punëdhënësi juaj ka vetëm detyrimin që t’ju lejojë të përdorni deri në 40 (ose 56) orë leje për arsye sigurie dhe shëndetësore për çdo vit kalendarik.

## Penalizimi

Punëdhënësi nuk mund t’ju penalizojë për kërkimin ose përdorimin e lejes për arsye sigurie dhe shëndetësore. Penalizimi përfshin çdo kërcënim, masë disiplinore, shkarkim, ulje në detyrë, pezullim ose reduktim të orëve tuaja të punës, ose çdo veprim tjetër të pavolitshëm punësimi ndaj jush për shkak të ushtrimit apo përpjekjes për të ushtruar çdo të drejtë të garantuar nga ligji, ku përfshihen masat e lidhura me statusin e perceptuar të emigrimit ose me autorizimin për punë.

## Ankesat

Ju mund të depozitoni një ankesë pranë DCWP-së. Për të marrë formularin e ankesës, vizitoni faqen e internetit [nyc.gov/workers](http://nyc.gov/workers) ose kontaktoni në numrin 311 (212-NEW-YORK jashtë qytetit të Nju-Jorkut).

*Përditësuar më datë 20.11.2020*



**Pyetje?** Për më shumë informacione ose për të kontaktuar me DCWP-në:

- Vizitoni faqen [nyc.gov/workers](http://nyc.gov/workers) për ligjin dhe për pyetjet më të shpeshta
- Adresa e email-it: [PSSL@dcwp.nyc.gov](mailto:PSSL@dcwp.nyc.gov)
- Telefononi në numrin **311** (212-NEW-YORK jashtë NYC) dhe thoni: “Leje për arsye sigurie dhe shëndetësore”